

VENDIM
Nr. 71, datë 27.1.2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 503, DATË 13.5.2009, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET QË OFROHEN
NGA AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 55, të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, dhe të nenit 35, të ligjit nr. 107/2015, “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 503, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“2. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik për zbatimin e këtij vendimi.”.
2. Në tabelën bashkëlidhur vendimit, emërtimi “Ofrues i shërbimit të certifikimit” zëvendësohet me “Ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama